



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit  
të Përgjithshëm Vlorë**

|                  |                     |                     |            |
|------------------|---------------------|---------------------|------------|
| Numri i Çështjes | 21234-02819-61-2019 | Data e Regjistrimit | 19/07/2019 |
| Numri i Vendimit | 61-2020-5144        | Data e Vendimit     | 24/12/2020 |

**VENDIM  
NE EMER TE REPUBLIKËS**

**Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë  
E PERBERE NGA:**

**KRYESUES:** Hektor Sinanaj

**ANËTAR**

**SEKRETARE** Edita Mataj

**Objekti:** Detyrimin e pales se paditur te paguaje ne favor te pales paditese  
shperblimin e plote te demit pasuror dhe jopasuror dhe jopasuror \*\*\*\*\*

**Baza Ligjore :** Neni 625 , 640 e vijues I K. Civil.

**Përmbledhja e vendimit:**

\*\*\*\*\*

<?xml:namespace prefix = "v" ns = "urn:schemas-microsoft-  
com:vml"

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR VLORE**

**Nr\*\*\*\*\* 2162 Akti**

**Nr\*\*\*\*\* 2421 Vendimi**

**Date 19\*\*\*\*\*07\*\*\*\*\*2019 Regjistrimi**

**Date 24\*\*\*\*\*12\*\*\*\*\*2020**

**V E N D I M**

**“NË EMËR TË REPUBLIKËS “**

**Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Vlorë e  
përbërë nga :**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit  
të Përgjithshëm Vlorë

Hektor Sinanaj -

Gjyqtar

Asistuar prej sekretares së seancës gjyqësore  
Edita Mataj , në seancë gjyqësore publike, mori në shqyrtim  
çështjen civile Nr\*\*\*\*\* 21s62 Akti , Date 19\*\*\*\*\*07\*\*\*\*\*2019  
Rregj që u përket palëve :

**PADITESA : \*\*\*\*\*** , e bija e Islam, e  
dtl\*\*\*\*\*26\*\*\*\*\*12\*\*\*\*\*1977, lindur e banuese ne Sevaster  
Vlore\*\*\*\*\*

\*\*\*\*\* e bija e Nuri,  
dtl\*\*\*\*\*12\*\*\*\*\*08\*\*\*\*\*1998, ne Vlore e banuese ne Gjermani,  
perfaqsuar me prokure, nga \*\*\*\*\*

\*\*\*\*\* , e bija e Islam,  
dtl\*\*\*\*\*27\*\*\*\*\*02\*\*\*\*\*1980 ne Vlore e banuese ne Dubai,  
perfaqsuar me prokure nga \*\*\*\*\*

\*\*\*\*\* , e bija e Islam,  
dtl\*\*\*\*\*10\*\*\*\*\*09\*\*\*\*\*1954, banuese ne Itali, perfaqsuar me  
prokure nga \*\*\*\*\*

\*\*\*\*\* , dtgbl\*\*\*\*\*31\*\*\*\*\*10\*\*\*\*\*1983, ne Vlore  
e banues ne Itali, perfaqsuar me prokure nga \*\*\*\*\*

\*\*\*\*\* , e bija e Islam,  
dtl\*\*\*\*\*27\*\*\*\*\*02\*\*\*\*\*1980 ne Vlore e banuese ne Itali,  
perfaqsuar me prokure nga \*\*\*\*\*

\*\*\*\*\* \*\*\*\*\* , e bija e Islam, dtl\*\*\*\*\*1w976,  
lindur ne Vlore e banuese ne Itali, perfaqsuar me prokure nga  
\*\*\*\*\*

Te gjithë paditesit jane perfaqsuar me prokure te  
posacme nr\*\*\*\*\*1425 rep\*\*\*\*\* , nr\*\*\*\*\*102e7 kol  
dt\*\*\*\*\*06\*\*\*\*\*07\*\*\*\*\*2019 notere Besa Nelaj Vlore, nga  
Avokat Nevrus Nana Dhoma e A vokatise Tirane\*\*\*\*\*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit  
të Përgjithshëm Vlorë

I PADITUR : \*\*\*\*\* (F\*\*\*\*\*SH\*\*\*\*\*ZH\*\*\*\*\*),  
perfaqsuar ne dy seanca me autorizim  
nga Fatjon Lleshi\*\*\*\*\*

**OBJEKTI**(Pas saktësimi të objektit material të padisë) :  
Detyrimin e pales se paditur te paguaje ne favor te pales paditese  
\*\*\*\*\* shperblimin e plote per demin shkaktuar shtetases \*\*\*\*\*  
ne vleren 5\*\*\*\*\*377\*\*\*\*\*714 Leke si dem jo pasuror (moral dhe  
egzistencial),

Detyrimin e pales se paditur te paguaje ne favor te pales  
paditese \*\*\*\*\* shperblimin e plote per demin shkaktuar shtetases  
\*\*\*\*\* ne vleren 5\*\*\*\*\*377\*\*\*\*\*714 Leke si dem jo pasuror  
(moral dhe egzistencial),

Detyrimin e pales se paditur te paguaje ne favor te pales  
paditese \*\*\*\*\* shperblimin e plote per demin shkaktuar shtetases  
\*\*\*\*\* ne vleren 5\*\*\*\*\*377\*\*\*\*\*714 Leke si dem jo pasuror  
(moral dhe egzistencial),

Detyrimin e pales se paditur te paguaje ne favor te pales  
paditese \*\*\*\*\* shperblimin e plote per demin shkaktuar shtetases  
\*\*\*\*\* ne vleren 5\*\*\*\*\*377\*\*\*\*\*714 Leke si dem jo pasuror  
(moral dhe egzistencial),

Detyrimin e pales se paditur te paguaje ne favor te pales  
paditese \*\*\*\*\* shperblimin e plote per demin shkaktuar shtetases  
\*\*\*\*\* ne vleren 5\*\*\*\*\*377\*\*\*\*\*714 Leke si dem jo pasuror  
(moral dhe egzistencial),

Detyrimin e pales se paditur te paguaje ne favor te pales



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë

paditese \*\*\*\*\* shperblimin e plote per demin shkaktuar shtetases  
\*\*\*\*\* ne vleren 5\*\*\*\*\*377\*\*\*\*\*714 Leke si dem jo pasuror  
(moral dhe egzistencial)\*\*\*\*\*

Detyrimin e pales se paditur te paguaje ne favor te secilit prej  
paditesave kamatevonesat sipas normes mesatare te Bankes se  
Shqiperise nga data e aksidentit 15\*\*\*\*\*08\*\*\*\*\*2017 deri ne  
ekzekutimin e plote te shumes nga i padituri\*\*\*\*\*

Detyrimin e palës së paditur të paguajë në favor të palës  
paditëse dhe të gjitha shpenzimet gjyqësore dhe avokatore\*\*\*\*\*

**BAZA LIGJORE** : Nenet 608 e vijues, 625, 640 e vijues te  
K\*\*\*\*\*Civil\*\*\*\*\*

Vendimi Unifikues nr\*\*\*\*\*12 dt\*\*\*\*\*14\*\*\*\*\*09\*\*\*\*\*2007 i  
Gjykates se Larte\*\*\*\*\* Kodi Rrugor\*\*\*\*\*

Gjykata ne perfundim te gjykimit, pasi degjoi palet ne  
konkluzionet perfundimtare, qe kerkuan : Pala paditese sipas  
kerkimeve te padise, pala e paditur rezimin e padise, per shkak  
moslegjitimimi dhe pabazueshmerise ne prova e ne ligj\*\*\*\*\*

-

### VEREN :

**Rezultuan te provuara ne gjykim rrethanat e faktit te  
parashtruara nga pala paditese, si me poshte :**

Me datë 15\*\*\*\*\*08\*\*\*\*\*2017 rreth orës 15\*\*\*\*\*30 në  
Rrugën Interurbane Vlorë -Peshkëpi , në vendin e quajtur “Cezma  
e Thatë“ ndodhur midis fshatrave Sherishtë dhe Peshkëpi, të  
qarkut Vlore, automjeti i markës Suzuki me targë AA 384 BM që  
drejtohej nga shtetasi Nikoll Kacaj ka dalë nga rruga dhe është  
përmbysur në kanal\*\*\*\*\* Për pasojë në këtë ngjarje ka marrë  
dëmtime të shëndetit shtetësja \*\*\*\*\* , e cila ka qenë pasagjere në  
këtë automjet\*\*\*\*\*



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë

Me aktin e ekspertimit mjeko ligjor Nr\*\*\*\*\*209 dt\*\*\*\*\*28\*\*\*\*\*08\*\*\*\*\*2017 ka rezultuar se dëmtimet e shtetases \*\*\*\*\* konsistojnë në thyerje të vertebrave të shtyllës kurrizore 10-11(torakale) me spostim të tyre dhe me shtypje të kanalit spinal\*\*\*\*\* Vështirësi në lëvizjen e këmbëve dhe vështirësi në urinim\*\*\*\*\* Keto dëmtime janë shkatuar me mjetë të forta mbrehtëse me mekanizim e goditjes dhe të përplasjes\*\*\*\*\* Dëmtimet e mësipërme janë klasifikuar si të tilla që sjellin humbje të aftësisë se përhershme për punë në masën mbi 1/3 (gjymtim)\*\*\*\*\*

Nga kryerja e Aktit të Riekspertimit Mjeko Ligjor për të dëmtuarën \*\*\*\*\* Nr\*\*\*\*\*2794 dt\*\*\*\*\*22\*\*\*\*\*12\*\*\*\*\*2017, nga ekspertët mjeko ligjore Elmaz Shaqiri dhe Admir Sinamati pranë IML Tiranë, është konkluduar se “në trupin e shtetases \*\*\*\*\* janë konstatuar frakturë kompresive (thyerje me shtypje) e rruazës së 12 torakale të shtyllës kurrizore\*\*\*\*\* Këto dëmtime janë shkaktuar me mjete të forta mbrehtëse karakteristike edhe për traumat automobilistike\*\*\*\*\* Dëmtimet e mësipërme janë klasifikuar si dëmtime që sjellin humbje të aftësisë së përkohshme për punë mbi 9 (nëntë) ditë\*\*\*\*\*

Sipas Aktit të Ekspertimit Auto Teknik të kryer me kërkesë të Prokurorisë së Rrethit Vlorë del se shkaku determinant në ardhjen e pasojës, dëmtimin e paditëses \*\*\*\*\* , është shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor të kryera nga enti rrugor, që konkretisht ka shkelur nenin 21 pika 1,2,3 të Ligjit nr\*\*\*\*\* 8378 dt\*\*\*\*\*22\*\*\*\*\*07\*\*\*\*\*1998 “Kodi Rrugor i R\*\*\*\*\*Sh\*\*\*\*\*”

Në bazë të Vendimit Nr\*\*\*\*\*335 dt\*\*\*\*\*26\*\*\*\*\*02\*\*\*\*\*2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me kërkuës Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, është vendosur pushimi i procedimit penal Nr\*\*\*\*\*1616 të vitit 2017 për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” parashikuar nga neni 290/2 të Kodit Penal, pasi për mungesë të pasojës rasti nuk ka përbërë vepër penale\*\*\*\*\*

Ballafaquar me ligjin-bazen ligjore te prerenduar dhe nga pala paditese ne kerkimet e padise, prapesimet e pales se



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit  
të Përgjithshëm Vlorë

paditur, me faktin e rezultuar nga c'muarja dhe e provave ne  
gjykim, gjykata aresyeton se :

Gjenden te pabazuara prapesimet e pales paditur ngritur  
dhe ne deklaraten e mbrojtës, lidhur me mungesen e pales  
paditur \*\*\*\*\* i Zhvillimi, te legjitimitetit pasiv te tyre ne  
gjykimin e kesaj mosmarveshje\*\*\*\*\*

Referuar pergjigjies dt\*\*\*\*\* 02\*\*\*\*\*05\*\*\*\*\*2018 me  
nr\*\*\*\*\* 3349/1 prot, të Autoritetit Rrugor Shqiptar, paraqitur si  
prove ne gjykim nga pala palditese, u provua se ishte \*\*\*\*\*  
ndertuesi i rruges dhe konkretisht : *"Ky segment rrugor sipas te  
dhenave qe ju na keni parashtruar ne lidhje me periudhen kohore  
te ndodhjes se aksidentit ka qene ne ndertim\*\*\*\*\* Ndertimi i saj  
po behet nga \*\*\*\*\* Autoriteti Rrugor Shqiptar  
administron rruget te cilat jane te perfunduara dhe pasi jane  
marre ne dorezim nga ana e tij\*\*\*\*\* Sa me siper duhet ti  
drejtoheni \*\*\*\*\* te \*\*\*\*\* per nje Informacion sa me  
te sakte \*\*\*\*\*"*

Pala e paditur ka legjitimim pasiv, bazuar ne Kthim  
Pergjigjen e mesiperme si dhe ne LIGJ Nr\*\*\*\*\*10 130, datë  
11\*\*\*\*\*5\*\*\*\*\*2009 PËR FONDIN SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT,  
ne nenin 6 te tij ku shpjegohet se: *1\*\*\*\*\* Objekti i veprimtarisë së  
FSHZH-së është, sipas rastit, hartimi, menaxhimi, financimi,  
zbatimi, mbikëqyrja e projekteve të lidhura me fushën e  
veprimtarisë\*\*\*\*\** Shikohet qarte se pala e Paditur ka si Objekt te  
veprimtarise se saj, zbatimin dhe mbikqyrjen e projekteve, ku  
pjese e mbikqyrjes eshte siguria e rrugeve, sinjalistika e tyre,  
mbarvajtia e punimeve, marrja e lejeve te ndryshme\*\*\*\*\*

Bazuar dhe ne nenin 623 te Kodit Civil i cili shprehet se:  
*Pronari i një ndërtese ose i një ndërtimi është përgjegjës  
për dëmet e shkaktuara nga të metat e çdo ves tjetër që  
ka lidhje me ndërtimin ose me mirëmbajtjen e tyre\*\*\*\*\** Ne  
rastin tone, *pronari i rruges* deri ne perfundimin te plote te saj dhe  
dorezimin tek ARRSH, *eshte \*\*\*\*\**, eshte ky i fundit pergjegjesi  
per demet e shkaktuara nga te metat qe kane lidhjen me ndertimin  
e atij segmenti rrugor dhe si i tille mban ne menyre direkte



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë

pergjegjesi per demshperblimin e paleve te treta nga demet qe ju kane ardhur atyre ne perdorimin e kesaj rruge\*\*\*\*\*

Legjitimimin e pales se Paditur del dhe nga Vendimi Nr\*\*\*\*\* 09 date 16\*\*\*\*\*10\*\*\*\*\*2017, Per Miratimin e Lejes se Ndertimit te Infrastruktures per Objektin: “Rehabilitimi i rruges se lumit te Vlores, Aksi Selenice-Kuc-Qeparo, Bashkia Vlore, Himare, Selenice” ku eshte Vendosur: *Miratimi me kusht i Lejes se Ndertimit te Infrastruktures “Rehabilitimi i Rruges se Lumit te Vlores, Aksi Selenice-Kuc-Qeparo”, me subjekt zhvillues \*\*\*\*\*n \*\*\*\*\* te \*\*\*\*\**, ku ne kete Vendim ben pjese dhe segmenti rrugore “Vlore-Peshkepi” ku u demtua pala Paditese\*\*\*\*\*

Leja e Ndertimit ka dale ne emer te \*\*\*\*\*t \*\*\*\*\* te \*\*\*\*\* , eshte ky i fundit subjekti pergjegjes per zhvillimin e projektit, mbikqyrjen dhe zbatimin e tij, duke u bere ne menyre direkte pergjegjes per cdo dem te shkaktuar paleve te treta, deme keto te shkaktuara nga perdorimi i ketij segmenti rrugor\*\*\*\*\* Pronar i rruges ku ka ndodhur aksidenti deri ne perfundimin e plote te saj dhe dorezimin e rruges Autoritetit Rrugor Shqiptar eshte \*\*\*\*\* Shqiptar i \*\*\*\*\* , eshte pikerisht ky i fundit pergjegjesi per demet e shkaktuara nga te metat e cdo ves tjeter qe ka lidhje me ndertimin ose me mirmbajtjen, te shkaktuara paleve te treta\*\*\*\*\* Ndaj, shperblimin e plote te demit pasuror dhe jo pasuror ( biologjik, moral, ekzistencial ) si pasoje e demtimit te shtetases \*\*\*\*\* , bene me legjitimitet akti palen paditese, per t’ja kerkuar pales se Paditur\*\*\*\*\*

\*\*\*\*\* si pale ndergjyqese ka legjitimim pasiv per te qene pjese e ketij procesi, sipas dhe ligjit te tij specifik, ketij enti/publik zbatues, ku nder te tjera ky person Juridik ka ne ushtrim te kompetencave te tij ligjore dhe menaxhimit, zbatimin, mbikqyrjen e projekteve të lidhura me fushën e veprimtarisë\*\*\*\*\* Ku pjese e zbatimit dhe te mbikqyrjes eshte dhe siguria rrugore, kjo e munguar ne faktin e rezultuar ne gjykim, qe ka sjelle si pasoje demtimin e pales Paditese\*\*\*\*\* Pavaresisht se perfitues eshte enti pronar i rrugeve, eshte FSHZH pergjegjesi kryesor per mbarevajtjen e punimeve, deri ne dorezimin perfundimtar te rruges\*\*\*\*\* Vertet FSHZH, nuk ka



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë

kryer apo po kryen punime, por eshte ky ent publik jo fitimprures, qe merret me zbatimin dhe mbikqyrjen e projektit, ku si pjese e zbatimit te projekti eshte dhe siguria rrugore, sinjalistika, marrja e lejeve te nevojshme per zhvillimin e tij\*\*\*\*\*

Pala e paditur pretendon qe nuk duhet te pergjigjet ajo per demin pasi punimet po kryhen me nenkontraktim nga shoqeri te tjera\*\*\*\*\*

**Gjykata gjene te bazuara pretendimet e pales paditese se :**  
Bazuar ne Vendimin e Keshillit Kombetar te Territorit, Nr\*\*\*\*\* 09 date 16\*\*\*\*\*10\*\*\*\*\*2017, Per miratimin e lejes se ndertimit te infrastruktures per objektin: *"Rehabilitimi i rruges se lumit te Vlores, akti Selenice-Kuc-Qeparo, Bashkia Vlore, Himare dhe Selenice eshte vendosur ne piken 1 te tij, Miratimi me kusht te Lejes se Ndertimit te Infrastruktures: "Rehabilitimi i Rruges se Lumit te Vlores, Aksi Selenice-Kuc-Qeparo" me subjekt zhvillues \*\*\*\*\*n \*\*\*\*\* te \*\*\*\*\* \*\*\*\*\** Si dhe ne piken 3, ky Vendim shprehet se, dokumentat e lejeve te ndertimit te infrastruktures i jepen subjektit kerkues sipas segmenteve te poshteshenuara, dhe nje nga segmentet eshte ai "Vlore-Peshkepi", segment ne te cilin eshte demtuar pala paditese\*\*\*\*\*

Duke qene se pala e Paditur e cila eshte dhe Mbikqyrese e Punimeve ka lidhur nje kontrate punimesh, te lidhur midis saj dhe shoqerise kontraktuese "Avtomagistrali-Tcherno More", dhe me pas nje tjeter kontrate punimesh eshte lidhur midis Kontraktorit dhe Nenkontraktorit te punimeve "Arifaj"Shpk, *eshte pikerisht Subjekti Zhvillues \*\*\*\*\* i Zhillimit, ai i cili duhet te monitoronte zhvillimin e ketij projekti\*\*\*\*\** Marredhenia qe ka i padituri me shoqerite nenkontraktore eshte nje marredhenie e posacme midis tyre, e cila rregullohet nepermjet kontratave qe ata kane lidhur me njeri tjetrin\*\*\*\*\* Keto kontrata rregullojme marredhenien e te paditurit me nenkontraktoret e tij, dhe kjo nuk ka asnje lidhje direkte me palen paditese, pasi vete dispozitat ligjore te percaktuara me siper pergjegjesine ja kane ngarkuar pronarit te saj\*\*\*\*\* Gjithashtu dhe policat e sigurimit qe jane sjelle, jane pikerisht per te garantuar zbatimin e kontratave midis te paditurit dhe nenkontraktoreve, dhe si nje marredhenie e





## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë

posacme midis tyre ajo police permban kushte per perfitimin, pjese te zbritshem, limit mbulimi etj\*\*\*\*\* Te gjitha keto vecori te kontratave apo policave te sigurimit nuk mund te ndikojne tek pergjegjesia e plote qe ka i padituri per demet ndaj paleve te treta, ndaj te cileve eshte i detyruar tu pergjigjet plotesisht\*\*\*\*\*

Sipas nenit 623 te Kodit Civil i cili shprehet se: *“Pronari i një ndërtese ose i një ndërtimi është përgjegjës për dëmet e shkaktuara nga të metat e çdo ves tjetër që ka lidhje me ndërtimin ose me mirëmbajtjen e tyre”, \*\*\*\*\** duhet te pergjigjet per cdo dem mund ti vij paleve te treta nga ndertimi qe eshte ne pronesi te tij\*\*\*\*\*

Gjykata konstaton se plotesohen elementet per pergjegjesi civile, ku eshte e nevojshme plotesimi i tre kushteve si dëmi, kundërligjshmëria e tij dhe lidhja shkakësore\*\*\*\*\* Për të lindur përgjegjësia civile e shkaktarit të dëmit, duhet që ky të ketë vepruar me faj\*\*\*\*\* Një kusht i tillë i përgjegjesisë parashikohet në Kodin Civil, neni 608 si vijon:

*“Personi që, në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar\*\*\*\*\*”*

Rezulton se pasoja ka qenë plagosja e lehtë e një personi (paditësja \*\*\*\*\*), dhe për këtë arsye çështja penale për *“Shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor”* sipas nenit 290 të K\*\*\*\*\*Penal është pushuar, dhe ne keto kushte nuk mund te kemi nje vendim penal te formes se prere per fajesine sipas nenit 70 te K\*\*\*\*\*Pr\*\*\*\*\*Penale\*\*\*\*\* Në një situatë të tillë është pranuar marrja e provës me ekspert sipas nenit 224/a të K\*\*\*\*\*Pr\*\*\*\*\*Civile, për të percaktuar subjektin përgjegjës për ndodhjen e këtij aksidenti\*\*\*\*\*

Ne gjykimi u u procedua, duke u caktuar nje ekspert autoteknik i cili konkludoi se aksidenti i ndodhur në datën



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit  
të Përgjithshëm Vlorë

15\*\*\*\*\*08\*\*\*\*\*2017 ka të bëjë me përgjegjësinë direkte me faj të palës së paditur, e cila gjatë kryerjes së punimeve të segmentit rrugor të sipërpërmendur nuk ka marrë masat e duhura për sinjalizimin e punimeve në vendin e ngjarjes, dhe largimin e materiale që bëheshin pengesë për qarkullimin rrugor\*\*\*\*\*

Sipas konkluzionit të ekspertit shkak i ndodhjes së aksidentit, ka të bëjë me mosmarrjen e masave për parandalimin e aksidentëve gjatë kohës që bëhen punime dhe përgjegjësi direkt për dëmet që vijnë si pasojë shkeljes së këtyre rregullave është pala e paditur,  
\*\*\*\*\*

Eksperti ka konkluduar : “Bazuar në dokumentet e ndodhura në dosje, të përcaktohet shkak determinant i ndodhjes së aksidentit dhe ardhjes së pasojës, kemi këtë konkluzion:

*Shkak i ardhjes së pasojës, dëmtimet e shtetases \*\*\*\*\* , e cila ishte pasagjere në automjetin e markës Suzuki me targë AA384 BM e pozicionuar në vendin e parë të automjetit janë mosrespektimi i rregullave të qarkullimit rrugor, pra shkeljet e konstatuar nga shoqëria që kishte marrë përsipër të rikonstruktonte rrugën dhe konkretisht, neni 21, pika 1,2,3, të ligjit nr\*\*\*\*\* 8378, datë 22\*\*\*\*\*07\*\*\*\*\*1998, ndryshuar me ligjin nr\*\*\*\*\*9808, datë 34\*\*\*\*\*09\*\*\*\*\*2007 dhe ligjin nr\*\*\*\*\* 10488 datë 05\*\*\*\*\*12\*\*\*\*\*2011’ Kodi Rrugor në Republikën e Shqipërisë” dhe nenet 29 dhe 30 të VKM nr\*\*\*\*\* 153 datë 07\*\*\*\*\*04\*\*\*\*\*2000 ‘Për miratimin e rregullave të zbatimit të Kodit Rrugor’\*\*\*\*\*”*

Në çështjen objekt gjykimi, kemi të bëjmë me përgjegjësinë direkte të palës së paditur, \*\*\*\*\* i cili gjatë kryerjes së punimeve të segmentit rrugor të sipërpërmendur nuk ka marrë masat e duhura për sinjalizimin e punimeve në vendin e ngjarjes, dhe marrjen e masave për qarkullim normal të mjeteve, cka ka sjellë dëmtimin e paditëses \*\*\*\*\*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit  
të Përgjithshëm Vlorë

Lidhur me dëmin pasuror, neni 640 i Kodit Civil parashikon se:

*“Dëmi pasuror që shpërblehet përbëhet nga humbja e pësuar dhe fitimi i munguar”\*\*\*\*\**

*Shpërblehen gjithashtu shpenzimet e kryera në mënyrë të arsyeshme për të shmangur ose pakësuar dëmin, ato që kanë qenë të nevojshme për të përcaktuar përgjegjësinë dhe masen e dëmit, si dhe shpenzimet e arsyeshme të kryera për të siguruar shpërblimin në rrugë jashtëgjyqësore”\*\*\*\*\**

Si pasojë e këtij aksidenti, e dëmtuara \*\*\*\*\* , ka humbur pjesërisht aftësinë për punë dhe ka kryer një sërë shpenzimesh të nevojshme spitalore dhe farmaceutike për rehabilitimin e saj\*\*\*\*\*  
Për këtë arsye kemi kërkuar të caktohet një mjek ligjor për të sqaruar demtimet e pësuar nga paditesja \*\*\*\*\* dhe masen e paafetisë për punë\*\*\*\*\*

Sipas aktit eksperiment të mjekut ligjor të caktuar nga gjykata, eksperti Dr\*\*\*\*\* Gjergji Syko, nga akti i datës 11\*\*\*\*\*11\*\*\*\*\*2020, ka rezultuar :

“1\*\*\*\*\* Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të venë në dispozicion nga gjykata, ekzaminimi radiologjik nga mjeku specialist, trauma që ka pësuar kjo shtetase i ka shkaktuar këto demtime : thyerje me shtypje të vertebres së dymbëdhjetë të shtyllës kurrizore në nivelin e krahërorit\*\*\*\*\* Demtimet e përshkruara më sipër janë të përhershme\*\*\*\*\*

2\*\*\*\*\* Shkalla e humbjes së aftësisë së përhershme në punë është 50 %”

Sa i përket vlerësimit të dëmit pasuror, duke qenë se e dëmtuara \*\*\*\*\* , ka qenë në punë, dëmi pasuror, përfshirë dhe shpenzimet spitalore e farmaceutike për të është në shumën



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit  
të Përgjithshëm Vlorë

6\*\*\*\*\*372\*\*\*\*\*843 leke\*\*\*\*\*

### *Dëmi jopasuror*

Dëmi jopasuror gjen mbështetje ligjore në Nenin 625 të Kodit Civil qe parashikon se: *“Personi që pëson një dëm, të ndryshëm nga ai pasuror, ka të drejtë të kërkojë të shpërblehet kur:*

*1\*\*\*\*\* Ka pësuar një dëmtim të shëndetit ose është cënuar në nderin e personalitetit të tij;*

*2\*\*\*\*\* Është fyer kujtimi i një të vdekuri dhe kërkohet nga bashkëshorti me të cilin ka bashkëjetuar deri në ditën e vdekjes ose nga të afërmit e tij\*\*\*\*\*”*

Dëm jopasuror përbëhet prej:

a) Dëm biologjik; b) Dëm moral; c) Dëm ekzistencial\*\*\*\*\*

### *Dëmi biologjik*

Dëmi biologjik apo i dëmtimi i shëndetit përbën në thelb cënimin e shëndetit dhe integritetit fizik e psikik të njeriut\*\*\*\*\* Ky dëm përbën objekt kërkimi të pavarur nga dëmi pasuror e llojet e tjera të dëmit jopasuror dhe masa e dëmshpërblimit duhet t'i përafrohet shkallës konkretë të cenimit të përhershëm ose të përkohshëm të integritetit fizik ose psikik të të dëmtuarit\*\*\*\*\*

Dëmi biologjik është figurë e posaçme e dëmit jopasuror dhe si i tillë, objekt kërkimi i pavarur të dëmshpërblimit përkatës\*\*\*\*\* Në dallim nga dëmet pasurore, dëmi biologjik nuk ka vlerë ekonomike në tregun e lire, cenimi i tij nuk kompensohet në natyrë dhe as nuk ka çmim në të holla\*\*\*\*\* Por, për efekt të mbrojtjes së shëndetit, lehtësimit dhe rehabilitimit fizik e social të të dëmtuarit në të ardhmen, personi përgjegjës për shkaktimin e dëmit biologjik detyrohet t'i paguaje atij një dëmshpërblim në të holla, në menyrë të pavarur nga dëme të tjera pasurore e jopasurore që eventualisht i dëmtuari ka pësuar për shkak të të njëjtit fakt të



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë

paligjshem\*\*\*\*\*

Në përgjigje të pyetjes cila është vlera e dëmit biologjik (terminal) dëmtimit të shëndetit për paditësen \*\*\*\*\* , do të kemi këtë konkluzion shumën prej 5\*\*\*\*\*377\*\*\*\*\*714 lek

#### *Dëmi moral*

Dëmi moral është shfaqje e brendshme, e përkohshme, e turbullimit të padrejtë të gjendjes shpirtërore të njeriut, dhimbje e vuajtje shpirtërore apo gjendje ankthi e mundimi shpirtëror që rrjedh si pasoje e faktit të paligjshem\*\*\*\*\* Cilido që pëson cenime në sferën e shëndetit dhe të personalitetit të tij nga veprimet a mosveprimet e paligjshme dhe me faj të nje të treti, ka të drejtën të kërkojë edhe dëmshpërblimin e dëmit moral të pësuar\*\*\*\*\* Kjo e drejtë, në cilësinë e të dëmtuarit, i përket individualisht edhe secilit prej familjareve të afert të personit që ka humbur jetën apo është dëmtuar nga fakti i paligjshem, duke qenë se vërtëtohet lidhja e tyre e posaçme familjare, ndjesore dhe e bashkëjetesës\*\*\*\*\* Dëmi moral i pësuar nga vetë të afërmit konsiderohet si pasoje, rrjedhim i menjëhershëm dhe i drejtpërdrejtë i të njëjtit fakt të paligjshëm\*\*\*\*\*

Në përgjigje të pyetjes cila është vlera e **dëmit moral** në formën e dhimbjes dhe të vuajtjes për paditësen \*\*\*\*\* , dhe paditësit e tjerë do të kemi këtë konkluzion:

- \*\*\*\*\*: dëmi minimal 1\*\*\*\*\*344\*\*\*\*\*428,5 leke, ndersa dëmi maksimal 2\*\*\*\*\*688\*\*\*\*\*857,5 leke\*\*\*\*\*
- \*\*\*\*\*: dëmi minimal 1\*\*\*\*\*344\*\*\*\*\*428,5 leke, ndersa dëmi maksimal 2\*\*\*\*\*688\*\*\*\*\*857,5 leke
- \*\*\*\*\*: dëmi minimal 1\*\*\*\*\*344\*\*\*\*\*428,5 leke\*\*\*\*\* , ndersa dëmi maksimal 2\*\*\*\*\*688\*\*\*\*\*857,5



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë

leke\*\*\*\*\*

- \*\*\*\*\*: dëmi minimal 1\*\*\*\*\*344\*\*\*\*\*428,5  
leke\*\*\*\*\* , ndersa dëmi maksimal 2\*\*\*\*\*688\*\*\*\*\*857,5  
leke\*\*\*\*\*
- \*\*\*\*\*: dëmi minimal 1\*\*\*\*\*344\*\*\*\*\*428,5  
leke\*\*\*\*\* , ndersa dëmi maksimal 2\*\*\*\*\*688\*\*\*\*\*857,5  
leke\*\*\*\*\*
- \*\*\*\*\*: dëmi minimal 1\*\*\*\*\*344\*\*\*\*\*428,5  
leke\*\*\*\*\* , ndersa dëmi maksimal 2\*\*\*\*\*688\*\*\*\*\*857,5  
leke\*\*\*\*\*
- \*\*\*\*\* \*\*\*\*\* , : dëmi minimal 1\*\*\*\*\*344\*\*\*\*\*428,5  
leke\*\*\*\*\* , ndersa dëmi maksimal 2\*\*\*\*\*688\*\*\*\*\*857,5  
leke\*\*\*\*\*

#### *Dëm ekzistencial*

Dëm eksitencial i shkaktuar nga fakti i paligjshëm i të tretit cenon të drejtat e personalitetit të njeriut duke dëmtuar thuajse në mënyre të përhershme shprehjen dhe realizimin e të dëmtuarit si njeri, shfaqjen e personalitetit të tij në botën e jashtme, duke tronditur objektivisht jetën e përditshme dhe veprimtarinë e zakonshme të tij, duke i shkaktuar përkeqësim të cilësisë së jetës nga ndryshimi dhe prishja e ekuilibrit, sjelljes e zakonëve të jetës, të marrëdhënieve personale e familjare\*\*\*\*\* Për shkak të një gjendjeje të tillë psiko-fizike, i dëmtuari nuk mund të kryejë më veprimtari të caktuara që karakterizojnë pozitivisht qenien e tij apo mund t'a karakterizojnë pozitivisht në të ardhmen, duke e detyruar të shtyhet drejt zgjidhjeve të ndryshme në jetë nga ato të dëshiruara e të pritshme apo në heqjen dore nga keto të fundit për shkak të vërtetimit të faktit të paligjshëm\*\*\*\*\*

Në përgjigje të pyetjes cila është vlera e demit ekzistencial, ose sic njihet ndryshe “dëmi mbi cilësinë e jetës” për paditësen \*\*\*\*\* , dhe paditësit e tjerë do të kemi këtë konkluzion:



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë

- [ ] [ ] [ ] [ ] [ ] [ ] \*\*\*\*\*: dëmi minimal 1 \*\*\*\*\* 344 \*\*\*\*\* 428, 5 leke,  
ndersa dëmi maksimal 2 \*\*\*\*\* 688 \*\*\*\*\* 857, 5 leke \*\*\*\*\*
- [ ] [ ] [ ] [ ] [ ] [ ] \*\*\*\*\*: dëmi minimal 1 \*\*\*\*\* 344 \*\*\*\*\* 428,5 leke,  
ndersa dëmi maksimal 2 \*\*\*\*\* 688 \*\*\*\*\* 857,5 leke
- [ ] [ ] [ ] [ ] [ ] [ ] \*\*\*\*\*: dëmi minimal 1 \*\*\*\*\* 344 \*\*\*\*\* 428, 5 leke,  
ndersa dëmi maksimal 2 \*\*\*\*\* 688 \*\*\*\*\* 857, 5 leke \*\*\*\*\*
- [ ] [ ] [ ] [ ] [ ] [ ] \*\*\*\*\*: dëmi minimal 1 \*\*\*\*\* 344 \*\*\*\*\* 428, 5 leke,  
ndersa dëmi maksimal 2 \*\*\*\*\* 688 \*\*\*\*\* 857, 5 leke \*\*\*\*\*
- [ ] [ ] [ ] [ ] [ ] [ ] \*\*\*\*\*: dëmi minimal 1 \*\*\*\*\* 344 \*\*\*\*\* 428, 5 leke,  
ndersa dëmi maksimal 2 \*\*\*\*\* 688 \*\*\*\*\* 857, 5 leke \*\*\*\*\*
- [ ] [ ] [ ] [ ] [ ] [ ] \*\*\*\*\*: dëmi minimal 1 \*\*\*\*\* 344 \*\*\*\*\* 428, 5 leke,  
ndersa dëmi maksimal 2 \*\*\*\*\* 688 \*\*\*\*\* 857, 5 leke \*\*\*\*\*
- [ ] [ ] [ ] [ ] [ ] [ ] \*\*\*\*\*: dëmi minimal 1 \*\*\*\*\* 344 \*\*\*\*\* 428, 5 leke,  
ndersa dëmi maksimal 2 \*\*\*\*\* 688 \*\*\*\*\* 857, 5 leke \*\*\*\*\*

Duke qene se dëmi ekzistencial është një dëm që duhet të provohet, sipas nenit 224/a të K\*\*\*\*\*Pr\*\*\*\*\*Civile kemi kërkuar marrjen e proves me ekspert psikolog \*\*\*\*\*

Sipas konkluzioneve të Vlerësimit Psikologjik të psikologes Elona Tocaj, shtetasja \*\*\*\*\* , për shkak të ngjarjes së ndodhur të dt\*\*\*\*\* 15\*\*\*\*\*08\*\*\*\*\*2017, ku ka mbetur e dëmtuar, i janë shkaktuar trauma psikologjike, duke cënuar personalitetin e saj, funksionimin e jetës së përditshme, stilin e prindërimit dhe marrëdhëniet ndërpersonale e gjithashtu i ka shkaktuar ngarkesë të lartë emocionale dhe psikologjike\*\*\*\*\*

Ndërsa për paditësit e tjerë, të afërm të të dëmtuares ekspertja psikologe vlerëson se ata manifestojnë simptoma të Crregullimit të stresit post traumatik dhe ankth të niveleve të larta\*\*\*\*\*

Nisur nga këto konkluzione të ekspertimit psikologjik të sipërcituar si dhe duke u nisur nga fakti se gjendja e tyre



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit  
të Përgjithshëm Vlorë

psikologjike është shumë e rënduar, gjykata gjene te bazuar kerkimin se duhet të japë për paditësit vlerën maksimale për dëmin ekzistencial\*\*\*\*\*

Sipas nenit 450 te Kodit Civil paditesave u takojne dhe kamate vonesat si pasoje e mospagimit ne kohe te shperblimit te demit\*\*\*\*\*

Lidhur me momentin e fillimit te kamate vonesave, bazuar nenin 481 pika c) e Kodit Civil, dhe ne zbatim te praktikës te Gjykates se Larte (shih vendimin Nr\*\*\*\*\*00-2011-725 i Vendimit (237) date 10\*\*\*\*\*05\*\*\*\*\*2011), *i padituri vihet ne vonese qe nga momenti qe e ka shkaktuar demin*, dhe ne rastin konkret *nga data e aksidentit*, pa qene nevoja e paraqitjes se nje kerkese formale\*\*\*\*\*

Gjendet i bazuar lidhur me kerkimin e kamatave, qe te njohe te drejten e perfitimit te kamate vonesave ne baze te neneve 450 e 481 pika c) te K\*\*\*\*\* Civil, sipas normes mesatare te Bankes se Shqiperise duke filluar nga data 15\*\*\*\*\*08\*\*\*\*\*2017 deri ne ekzekutimin e detyrimit nga pala e paditur\*\*\*\*\*

### PER KETO ARESYE :

Gjykata pasi pa dhe nenet 309 e 310 te  
K\*\*\*\*\*Pr\*\*\*\*\*Civile\*\*\*\*\*

Pranimin e padisë\*\*\*\*\*

Detyrimin e pales se paditur \*\*\*\*\* te paguaje ne favor te pales paditese \*\*\*\*\* shperblimin ne vleren 17\*\*\*\*\*128\*\*\*\*\*271 Leke, si dem pasuror dhe jo pasuror (biologjik, moral, egzistencial),

Detyrimin e pales se paditur \*\*\*\*\* te paguaje ne favor te paditesve te tjere : \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* shperblimin per demin shkaktuar shtetases \*\*\*\*\* , ne vleren 5\*\*\*\*\*377\*\*\*\*\*714 Leke, si dem jo pasuror (moral dhe





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit  
të Përgjithshëm Vlorë**

egzistencial), per secilin padites\*\*\*\*\*

Detyrimin e pales se paditur te paguaje ne favor te secilit prej paditesave kamatevonesat sipas normes mesatare te Bankes se Shqiperise nga data e aksidentit 15\*\*\*\*\*08\*\*\*\*\*2017 deri ne ekzekutimin e plote te shumes nga i padituri\*\*\*\*\*

Detyrimin e palës së paditur të paguajë në favor të palës paditëse shpenzimet gjyqësore\*\*\*\*\*

Kunder vendimit lejohet ankim brenda 15 diteve ne Gjykatën e Apelit Vlorë\*\*\*\*\*

**Vlore ne dt\*\*\*\*\* 24**

**\*\*\*\*\*12\*\*\*\*\*2020**

**SEKRETARE  
GJYQTARI**

**EDITA MATAJ  
HEKTOR SINANAJ**

**Për keto arsye:**

\*\*\*\*\*

\*\*\*\*\*

Ky dokument është marrë nga [www.gjykata.gov.al](http://www.gjykata.gov.al). Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.